



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Skenderajt
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Drejtoria për Arsim / Department of Education

Nr. 499/2024
Dt: 25.11.2024

Bazuar në nenin 8 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, në nenin 95 dhe 96 nenit 97 paragrafi 1 si dhe nenit 103 paragrafi 2 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, neni 62 të Ligjit për Vetqeverisjen Lokale nr.03/L-040, në Rregulloren (QRK) Nr.27/2024 për procedurat konkurrimit për nëpunësit teknik dhe mbështetës, Drejtoria e Arsimit në Skenderaj, shpall:

KONKURS PËR PLOTËSIMIN E VENDEVE TË PUNËS

Pozita: Nëpunës/e mbështetës/e dhe teknik/e

1. Punëtor/e teknik/e – në IP “Nëna Zahide” Skenderaj (1 pozitë)
2. Punëtor/e teknik/e – në Çerdhen e Re në Skenderaj (1 pozitë)

Lloji i vendit të punës: me orar të plotë;

Numri i pozitave: 1 (një) ekzekutues;

Periudha e Kontratës: Në kohë të pacaktuar;

Kohëzgjatja e punës provuese: Gjashtë (6) Muaj;

Detyrat dhe përgjegjësitë e punës për punëtor/e teknik/e:

- Të pastrojë dhe mirëmbajë të gjitha ambientet e shkollës, të mirëmbajë dhe pastrojë sipërfaqet e gjelbëruara të shkollës.
- Të ruajë mirë pasurinë e institucionit edukativo-arsimor dhe ta përdorë atë me kujdes.
- Të identifikojë, të evidentojë, të llogarisë dhe të planifikojë në afate periodike, të caktuara nga drejtori, shpenzimet që krijohen me amortizimin ose harxhimin e mjeteve të punës.
- Të mirëmbajë objektin, të kujdeset për shpenzimet e lëndëve djegëse, ruajtjen e pajisjeve për mirëmbajtje të higjienës dhe, sipas nevojës, t’ia prezantojë drejtorit planifikimin e përgjithshëm të shpenzimeve të institucionit edukativo-arsimor për çështjen e higjienës.

Kërkesat e përgjithshme për pranim:

Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;

Të ketë zotësi të plotë për të vepruar; Të zotërojë njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;

Të jetë i aftë në pikëpamje shëndetësore për të kryer detyrën përkatëse;

Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje;

Të mos ketë në fuqi një masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik, të pushuar sipas këtij ligji.

Kërkesat e përgjithshme formale:

Shkolla e Mesme

Dokumentacioni që duhet paraqitur për aplikim janë:

Formulari i aplikimit, i plotësuar;

Kopjet e dokumentit personal (letërnjoftim ose pasaportë);

Kopja e Diplomës së Shkollës së Mesme (noterizuar)

Rezymeja personale (CV)

Kopjet e dëshmisë së trajnimeve

Dokumenti që nuk jeni dënuar me vendim të formës së prerë (lëshuar nga Gjykata Themelore, jo më i vjetër se 6 muaj);

Certifikata e Mjekut pas përzgjedhjes nga komisioni.

Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve:

a. Jetëshkrim (deri në 30 pikë)

b. Intervistë me gojë (deri në 70 pikë)

Mënyra e aplikimit:

Çdo aplikues duhet të plotësojë dhe dorëzojë dokumentacionin si në vijim:

Fletë - aplikacionin e plotësuar;

Dokumentet e dërguar pas afatit dhe ato të pakompletuara nuk do të shqyrtohen;

Aplikacionet merren në Zyrën Pritëse QSHQ Arkivë (numër 13,14,15) në Administratën e Komunës dhe të plotësuara dorëzohen nga ora 08:00 deri në ora 16:00;

Data e aplikimit prej datës **26.11.2024** deri me datën **10.12.2024**;

Konkursi është i hapur për aplikim **15** ditë.

Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët dhe shpallja e rezultateve përfundimtare:

Përmes web faqes së Komunës së Skenderajt dhe portalit për rekrutim elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

Sqarime shtesë: Informata të sakta dhe të vërteta do të konsiderohen vetëm ato informata, të cilat janë të dëshmuara me dokumente (jo ato që janë vetëm të deklaruara pa dëshmi). Konkurrimi është i hapur për të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës si dhe komuniteti jo shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional, siç specifikohet në Ligjin për Zyrarët Publik.